




REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO			
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT			
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE			
ANTI-CORRUPTION AGENCY			
Dep.	Nr Prot.		
Dep- <u>2-D/DPK</u>	Br Prot	<u>01-2039/13</u>	
Dep	Prot No		
Nr i faq	Data		
Broj stranica	Datum	<u>08-07-2013</u>	
Nr. pages	Date		
PRISHTINE			



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosova**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 04.07.2013, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

**I. Mbyllët rasti më nr.AKK-03-1477/13, z. Cuneyd Ustaibo, Zëvendës Ministër në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, ne Qeverinë e Republikës së Kosovës ,për shkak se zyrtari i lartë publikë ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

**A r s y e t i m**

**I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të mundshëm të interesit është zhvilluar procedura e parapare sipas nenit 18.1 dhe 18.2 të ligjit Nr.04/L-051, Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.**

Pas identifikimit të rastit, ka filluar shqyrtimi i lëndës me numër protokolli AKK-03-1477/13, që për trajtim ka pasur zyrtarin e lartë z. Cuneyd Ustaibo, Zëvendës Ministër në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, ne Qeverinë e Republikës së Kosovës, ku është dyshuar për gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit, pasi që ushtron edhe pozitën e personit të autorizuar në Kompaninë private "A.G.O-AL-Sh.p.k" Prishtinë, Kosovë.

Agjencia kundër Korrupsionit me datën 21.05.2013, e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet që posedon Agjencia.

Pas këtyre procedurave, zyrtari i lartë z. Cuneyd Ustaibo, pasi ka kontaktuar me zyrtarët e Agjencisë ka kërkuar të takohemi dhe të bisedojmë rreth çështjes së ngritur, sipas procedurës është organizuar takimi me z. Ustaibo, dhe gjat takimit i kemi shpjeguar për fillimin e hetimeve lidhur me konfliktin e mundshëm të interesit në ushtrimin e funksionit publik. Gjatë takimit zyrtari ne fjalë e ka potencuar se ushtron funksionin e Zëvendës Ministrit në Ministrinë e

Tregtisë dhe Industrisë ne Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe është i regjistruar si person i autorizuar në biznesin private, Kompaninë "A.G.O-AL-Sh.p.k" Prishtinë, Kosovë.

Gjatë takimit zyrtari në fjalë ka pranuar dëshmitë e AKK-së dhe është zotuar se do të mundohet që ne afat sa më të shpejtë do të bëjë ndryshimet dhe do të japë dorëheqje nga pozita e personit të autorizuar dhe do ta shmangë çfarëdo situatë që mundë të shkaktoj konflikt të interesit.

Pas këtij takimi zyrtari i lartë z. Cuneyd Ustaibo, ka sjellë ne Agjenci dëshmitë e lëshuara nga ARBK-ja, ku dëshmon se është tërhequr nga të qenurit person i autorizuar ne Kompaninë private "A.G.O-AL-Sh.p.k" Prishtinë .

Duke u bazuar ne dëshmitë e ofruara nga zyrtari i lartë z. Cuneyd Ustaibo, Konstatojmë se : zyrtari i lartë z. Cuneyd Ustaibo, Zëvendës Ministër në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, ne Qeverinë e Republikës së Kosovës, ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit ne të cilën ndodhej.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari ndihmës)

Hasan Preteni  
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

